



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenin 17 të Rregullores QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të neneve 15 paragrafi 2.4, dhe nenit 17 të Statutit të Komunës Nr.Prot: 01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.06.2024 miratoi këtë;

### **VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNES**

#### **Neni 1**

Formohet komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për dhjetë (10) vite sipas vendimit nr.prot.01-020/04-0041871/24 të datës 27.06.2024, për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme të Komunës- Njësia kadastrale P- 209-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Lupç i Poshtem me sipërfaqe 38882m<sup>2</sup>, kullosë e klasës së tretë (3) në vendin e quajtur “Bugurdull”, me destinim sipas hartës zonale, zonë bujqesore.

Lirika Maliqi, nga Kuvendi i Komunës

Edona Shabani, nga Kuvendi i Komunës

Alban Zeka, nga Ekzekutivi i Komunës

Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës

Fadil Halimi, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

#### **Neni 2**

Mandati i Komisionit është i përkohëshem dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit nr.prot.01-020/04-0041871/24 të datës 27.06.2024, të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

### Neni 6

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren Nr.06/2021.

Nr.Prot.01-020/04-0041871/24  
Podujevë datë, 27.06.2024

